



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



*Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja*  
*2021-2024*

Miratuar me Vendimin e Dekanatit  
Nr. 150 datë 21.12.2021

Dhjetor 2021





## Përmbajtja

1. Hyrje
2. Vizioni, misioni
3. Objektivat strategjike, veprimet dhe rezultatet e pritshme





## Hyrje

Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja mbështetet në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, në strategjinë kombëtare të arsimit 2021-2026, në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, në strategjinë e edukimit dhe formimit 2020 të Komisionit Evropian (Education and Training 2020 strategy (ET2020)).

Ambicia e kësaj strategjie është të krijojë një ofertë formimi në përputhje me nevojat socio-ekonomike, cilësore, duke synuar punësimin sa më të madh të të rinjve dhe nga ana tjetër, të strukturohet kërkimi rreth boshteve multidisiplinare duke thithur projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me fokus çështjet që lidhen me fushat e studimit në këtë fakultet.

Gërshetimi i veprimtarisë formuese dhe kërkimore me pritshmëritë e vendit është një hallkë e rëndësishme për përmirësimin e integritit profesional të studentëve, rritjen e atraktivitetit të fakultetit, forcimin e identitetit të tij dhe përfaqësimin e tij të sigurtë në modelin aktual, novator të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Kjo startegji do të ndiqet hap pas hapi në kushtet e një realiteti të ri mbarë botëror ku pandemia e COVID19 ka kushtëzuar veprimtari e sipërmarrje të ndryshme si edhe në një situatë ku çështja e ndotjes së mjedisit dhe e ngrohjes globale janë kthyer në çështje madhore të reflektimit dhe ndërveprimit të të gjithë aktorëve.



### Vizioni

- Fuqizimi i institucionit ku dija dhe kërkimi shkencor të jenë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të kohës.
- Ndërkombëtarizimi edhe më shumë i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në mënyrë që ai të jetë një zgjedhje e parapëlqyer për studentët vendas dhe të huaj.

### Misioni

Misioni ynë si Fakultet është që t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet një formimi me cilësi të lartë për t'i pajisur studentët me aftësi të mira profesionale në përshtatje me kërkesat e tregut të punës, garantimit të suksesit të tyre, rritjes së cilësisë së aktivitetit kërkimor sipas standardeve ndërkombëtare, zhvillimit të inovacionit dhe të një komuniteti gjithëpërfshirës.

Fuqizimi i njësisë bazë të FGJH duke garantuar prurje të studentëve nëpërmjet një strategjie të promovimit të studimeve si edhe ridimensionimit të veprimtrisë mësimore, kërkimore dhe kulturore në to.

### Vlerat

- Profesionalizmi
- Integriteti
- Respekti
- Diversiteti
- Gjithëpërfshirja
- Transparenca



## Objektivat

Realizimi i objektivave përbën një angazhim me përgjegjësi dhe për këtë qëllim e mendojmë si të domosdoshme një qasje të strukturuar përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie dhe një plani veprimi.

Zbatimi i kësaj strategjie kërkon bashkimin e energjive të brendshme të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve të fakultetit në bashkëpunim me Rektoratin e UT, Fakultetet dhe strukturat e tjera të UT, si edhe mbështetjen e partnerëve të shumtë kombëtarë e ndërkombëtarë të sferës universitare, të shoqërisë civile, të komunitetit dhe të biznesit.

### Objektivi 1: Organizimi dhe drejtimi efektiv

Struktura organizative efektive është jetësore për të ofruar këtë strategji.

#### Veprimet që do të kryhen:

Përgatitja e këtyre dokumenteve të politikave:

- 1.1. Plani strategjik për promovimin e fakultetit dhe zhvillimin e departamenteve;
- 1.2. Strategjia e ndërkombëtarizimit;
- 1.3. Strategjia e partneritetit;
- 1.4. Politika për zhvillimin e kurrikulave;
- 1.5. Politika e sigurimit të cilësisë;
- 1.6. Politika për rekrutimin dhe promovimin e stafit akademik;
- 1.7. Politika për përditësimin e aftësimeve të stafit administrativ;
- 1.8. Politika për rekrutimin dhe pranimin e studentëve;
- 1.9. Strategjia e kërkimit shkencor;
- 1.10. Strategji për aftësimin në teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit.



### Rezultatet e pritshme:

- 1.1. Dokumentet e politikave dhe planeve të veprimit;
- 1.2. Kuadri rregullator i përmirësuar, si: rregullorja e përgjithshme e Fakultetit, rregulloret e përmirësuara të studimit, rregulloret e departamenteve, rregullorja e komisionit të doktoraturës, rregullorja e funksionimit të administratës.

### Objektivi 2: Formulimi i planit financiar, që do të mbështesë zhvillimin e parashikuar institucional

Zbatimi i kësaj strategjie do të kërkojë investime afatgjata të mbështetura nga një plan financiar i fortë. Kjo do të përqendrohet në gjenerimin e të ardhurave dhe shpenzimet e menaxhimit, duke rritur fitimet tona për investime në prioritetet strategjike. Mbështetja financiare për kërkimin shkencor kërkon diversifikim të burimeve financiare të Fakultetit, duke mos u mbështetur vetëm në burimet e brendshme. Inkurajimi për aplikime në projekte ndërkombëtare që kanë në qënder kërkimin dhe financohen nga BE-ja apo fondacione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunimi i ngushtë me sektorin privat, duke e orientuar kërkimin shkencor nga tregu, janë disa nga instrumentat që do të përdoren për të mbështetur financiarisht punën kërkimore të stafit akademik të Fakultetit.

### Veprimet që do të kryhen:

- 2.1. Ne do të mbrojmë burimet tona kryesore të të ardhurave dhe do të përmirësojmë konkurrencën përmes një qasjeje të fokusuar dhe të orientuar drejt tregut për ofertën tonë arsimore. Ne do të përshtasim me shpejtësi ofertën tonë të programeve akademike në përputhje me kërkesat e tregut;
- 2.2. Ne do të diversifikojmë dhe rritim të ardhurat tona përmes kërkimit dhe shërbimeve akademike;



2.3. Ne do të përdorim një qasje të planifikuar me kujdes për zbatimin e kësaj strategjie, duke ndërmarrë iniciativa për të përmirësuar kapacitetin, produktivitetin dhe efikasitetin për të arritur përfitime, duke gjeneruar burime për investime.

#### **Rezultatet e pritshme:**

- 2.1. Ngritja e qendrës së gjuhëve të huaja dhe ofrimi i shërbimeve për të tretët;
- 2.2. Ngritja e qendrës së trajnimeve si shërbime ndaj të tretëve;
- 2.3. Ngritja e qendrës së përkthimeve si shërbime ndaj të tretëve.

#### **Objektivi 3: Ndërtimi i markës dhe identitetit për promovimin e Fakultetit**

##### **Veprimet që do të kryhen:**

- 3.1. Të identifikojmë thelbin e institucionit tonë dhe të kuptojmë përbërjen e tij; çfarë përcakton frymën dhe përvojën e FGJH-së, si mund të dallojmë nga konkurrentët;
- 3.2. Të njohim audiencën ekzistuese dhe potenciale të synuar, për të kuptuar demografinë, për të identifikuar se çka motivon procesin e vendimmarrjes dhe për të arritur të prekim mendjet dhe zemrat e tyre;
- 3.3. Të përgatisim një plan strategjik të markës;
- 3.4. Projektimi i materialeve të publicitetit dhe marketingut që promovojnë një profil dhe një vlerë të dallueshme dhe të shquar të markës;
- 3.5. Fuqizimi i aktivitetit “Dyer të hapura” për maturantët;
- 3.6. Funksionimi i zyrës së komunikimit për marketing, promovim dhe informim mbi programet e formimit dhe shërbimet e ofruara nga Fakulteti për nxënësit e shkollave të mesme, institucionet, ndërmarrjet, aktorë të huaj në rajon dhe më gjerë.



### Rezultatet e pritshme:

- 3.1. Plani strategjik i markës;
- 3.2. Krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të identitetit vizual dhe veprues;
- 3.3. Logo e kuptimshme dhe tërheqëse;
- 3.4. Karakteristikat e imazhit;
- 3.5. Broshura, katalogë, website, media elektronike;
- 3.6. Modeli i ri i website;
- 3.7. Krijimi i rrjetit të ambasadorëve të markës.

### Objektivi 4: Vendosja e studentëve në qendër të veprimtrisë së Fakultetit

#### Veprimet që do të kryhen:

- 4.1. Përfshirja e studentëve në marrjen e vendimeve në lidhje me politikat dhe praktikën e mësimdhënies dhe të nxënies;
- 4.2. Bashkëpunimi me Këshillin e Studentëve për të ofruar një sërë aktivitete dhe mjedisesh sociale, sportive, artistike, kulturore dhe të tjera
- 4.3. Mbështetja dhe nxitja e studentëve që të përfshihen plotësisht në jetën universitare përmes klubeve studentore, ngjarjeve akademike dhe sociale;
- 4.4. Mbështetja dhe nxitja e studentëve për vullnetarizëm dhe për të marrë pjesë në aktivitete të tjera brenda komuniteteve lokale, kombëtare apo ndërkombëtare;
- 4.5. Sigurimi i mjediseve, fizike dhe digjitale, të cilat i mbështesin studentët në pjesëmarrjen aktive në jetën universitare;
- 4.6. Krijimi i një qendre për aktivitete jashtë kurrikulare për të siguruar aktivitete sportive, kulturore, artistike, sociale dhe vullnetare.





### Rezultatet e pritshme:


- 4.1. Ngritja e klubeve studentore;
- 4.2. Vënia në funksionim e Zyrës së Këshillimit të Karrierës
- 4.3. Funksionimi i qendrës për aktivitete jashtëkurrikulare.
- 4.4. Mbështetja për veprimtarinë e Këshillit të Studentëve.

### Objektivi 5: Përmirësimi i nivelit të studimeve për studentët

Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë më tej jetën akademike dhe atë kulturore të studentëve tanë, duke i vendosur ata në qendër të veprimtarive mësimore me një theks në partneritetin dhe personalizimin e të mësuarit.

### Veprimet që do të kryhen:

- 5.1. Promovimi, mbështetja dhe sigurimi i burimeve të nevojshme për mësimdhënien e grupeve të vogla;
- 5.2. Dhënia e fidbekut studentëve si mund të përmirësohen, si edhe komente për përparimin dhe arritjet e tyre;
- 5.3. Krijimi i hapësirave të mësimi, kërkimit dhe hapësirave sociale që mbështesin përkatësinë në një bashkësi akademike;
- 5.4. Sigurimi i mundësive për praktikë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- 5.5. Ofrimi i mundësisë për të gjithë studentët për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në kërkim, sipërmarrje, vendimarrje, etj, nëpërmjet organizimit të forumeve të ndryshme
- 5.6. Ofrimi i orientimit në karrierë dhe zhvillimi i aftësive të punësimit në një mënyrë që është e arritshme për të gjithë studentët gjatë gjithë kohës së tyre të studimit në FGJH.



**Rezultatet e pritshme:**

- 5.1. Zbatimi i qasjes me në qendër studentin;
- 5.2. Zhvillimi i zyrës së rekrutimit dhe pranimit të studentëve;
- 5.3. Dhënia e çmimeve për studentët për relizimin e projekteve apo veprimtarive të ndryshme.

**Objektivi 6: Zhvillimi i aftësive kërkimore të studentëve**

**Veprimet që do të kryhen:**

- 6.1. Trajnimi i studentëve për kërkimin shkencor.
- 6.2. Mentorimi i studentëve për kërkimin shkencor;
- 6.3. Përfshirja e studentëve në grupet e kërkimit shkencor;
- 6.4. Financim i përvitshëm i projekteve studimore të studentëve në bazë të projekt-propozimeve që do të vijnë në Dekanat, vlerësimeve që Dekanati do t'u bëjë (rankimi) dhe vendimmarrjes së financimit e projekteve më të mira. Aktivitetet që do të shpallet në medialet sociale dhe në webin e FGJH-së duke përcaktuar kriteret dhe periudhën kohore të dorëzimit të projekt-propozimeve.

**Rezultatet e pritshme:**

- 6.1. Organizimi i konferencës së përvitshme të studentëve;
- 6.2. Botimi i revistës me punimet e studentëve;
- 6.3. Botimi i një News Letter përgatitur nga Klubi Studentor i përgatitjes së revistës dhe news letter;
- 6.4. Pajisja me aftësi kërkimore e studentëve për të kryer kërkime të llojeve të ndryshme



## Objektivi 7: Zhvillimi i kurrikulës

Zhvillimi i kurrikulës është thelbësor për cilësinë e mësimdhënies. Ne synojmë të vazhdojmë të përforcojmë qasjen e të mësuarit, nga vënia e theksit në njohjen e fakteve dhe koncepteve në vënie të theksit në kompetencat e përcaktuara për të garantuar që të diplomuarit të kenë aftësitë e nevojshme si qytetarë të shekullit të njëzet e një. Në këtë kontekst, qëllimi ynë është të zhvillojmë një kurrikul të bazuar në kompetenca, me në qendër studentin dhe të bazuar në kërkime.

### Veprimet që do të kryhen:

- 7.1. Rishikimi i programeve të studimit;
- 7.2. Zbatimi i qasjeve të mëposhtme në zhvillimin e kurrikulës;
  - kurrikula e bazuar në kompetenca
  - kurrikula me në qendër studentin
  - kurrikula e bazuar në kërkime.
- 7.3. Përditësimi i kurrikulave ekzistuese;
- 7.4. Përgatitja e broshurës së studentëve;
- 7.5. Vlerësimi i kurrikulës;
- 7.6. Akreditimi i programeve të studimit.

### Rezultatet e pritshme

- 7.1. Paketa për zhvillimin e kurrikulës;
- 7.2. Publikimi i Buletinit të programeve të studimit;
- 7.3. Paketa e instrumenteve të vlerësimit të kurrikulës;
- 7.4. Programet e akreditura.



### **Objektivi 8: Zhvillimi i metodologjive të mësimdhënies dhe të nxënit**

Ky qëllim do të arrihet përmes vlerësimit dhe mbështetjes së inovacionit në mësimdhënie dhe promovimit të kontributeve të pedagogëve në dialogun akademik për mësimdhënien dhe të nxënit.

#### **Veprimet që do të kryhen:**

- 8.1. Mbështetja e pedagogëve për të arritur potencialin e tyre të plotë përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm;
- 8.2. Zhvillimi i metodologjive të mësimdhënies bazuar në qasjen e përzier të të mësuarit dhe përmirësimi i aftësive të tyre digjitale;
- 8.3. Zbatimi i modeleve inovative të mësimit miks, si: kombinimi i mësimit në auditor, jashtë tij dhe në platformat digjitale, përfshirja e mediave sociale, etj.;
- 8.4. Mësimdhënia e orientuar drejt kërkimit, e cila do të realizohet nëpërmjet të kuptuarit dhe zbatimit të metodologjive, aftësive dhe teknikave të kërkimit në disiplina mësimore;
- 8.5. Mësimdhënia e bazuar në mentorimin kërkimor, e cila do të realizohet nëpërmjet mentorimit të studentëve nga pedagogët për shkrimin e kumtesave për konferencën e studentëve, për punimet e diplomës dhe për vlerësimin e punimeve shkencore;
- 8.6. Fuqizimi i mësimdhënies së bazuar në kërkim, e cila do të realizohet nëpërmjet detyrave kërkimore të shkallës së vogël në lëndë të veçanta; si ese, studime rasti, analiza.

#### **Rezultatet e pritshme:**

- 8.1. Krijimi i Degës së Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulës;
- 8.2. Trajnime për përditësimin e aftësive mësimdhënëse nëpërmjet teknologjive të reja;
- 8.3. Përgatitja e materialeve mësimore digjitale;
- 8.4. Përdorimi i fidbekut të studentëve për mësimdhënien;
- 8.5. Përdorimi i platformës elektronike/mjeteve teknologjike për vlerësimin e studentëve;
- 8.6. Dokumenti i politikave për integritetin e kërkimit të pedagogëve dhe studentëve.



## Objektivi 9: Sigurimi i Cilësisë

### Veprimet që do të kryhen:

- 9.1. Funksionimi i Zyres së Sigurimit të Cilësisë;
- 9.2. Identifikimi dhe analiza e pikave të forta dhe të dobëta të veprimitarisë së përgjithshme të institucionit;
- 9.3. Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve të programeve studimore;
- 9.4. Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së përgatitjes së studentëve;
- 9.5. Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve kërkimore-shkencore;
- 9.6. Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve profesionale nga stafi akademik dhe administrativ;
- 9.7. Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së shërbimeve që FGJH-ja u ofron studentëve;
- 9.8. Monitorimi dhe vlerësimi i menaxhimit të burimeve financiare;
- 9.9. Digjitalizimi i arkivës për të pasur akses të menjëhershëm në informacion dhe minimizimin e pasojës kohë në vjetërsimin e dokumentacionit;
- 9.10. Propozimi i një plani veprimi për të sjellë përmirësim, ndryshim dhe zhvillim.

### Rezultatet e pritshme:

- 9.1. Publikimi i paketës së instrumenteve të vlerësimit të cilësisë;
- 9.2. Realizimi i vlerësimit të brendshëm;
- 9.3. Realizimi i akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit;
- 9.4. Trajnime për sigurimin e cilësisë.



## Objektivi 10: Zhvillimi i qasjes ndërdisiplinore dhe bashkëpunuese në kërkim

### Veprimet që do të kryhen:

- 10.1. Ngritja e grupeve mësimore-kërkimore në Fakultet;
- 10.2. Përgatitja e strategjisë së kërkimit;
- 10.3. Përgatitja e paketës së projekteve kërkimore;
- 10.4. Krijimi i një baze të dhënash për kërkimin;
- 10.5. Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore - Ngritja e Zyrës së Projekteve;
- 10.6. Zhvillimi i marrëdhënieve të reja kërkimore me bizneset dhe institucionet e tjera akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- 10.7. Mbështetja dhe promovimi akademik i pedagogëve;
- 10.8. Krijimi i çmimit: "Kërkimi më i mirë i vitit";
- 10.9. Fuqizimi i revistës së FGJH-së.

### Rezultatet e pritshme:

- 10.1. Dokumenti i strategjisë së kërkimit;
- 10.2. Paketa e projektit kërkimor;
- 10.3. Krijimi i Zyrës së Projekteve;
- 10.4. Baza e të dhënave kërkimore;
- 10.5. Sigurimi i një mbështetjeje financiare për pjesëmarrjen në aktivitetet kërkimore ndërkombëtare;
- 10.6. Rritja e numrit të pedagogëve të promovuar me grada e tituj akademikë.



**Objektiv 11: Zgjerimi i partneriteteve për të mbështetur mësimdhënien, të nxënit, punësimin e studentëve**

**Veprimet që do të kryhen:**

- 11.1. Identifikimi i partnerëve qëllimet e të cilëve janë në përputhje me ato të FGJH-së për të rritur mundësitë e të nxënit të bazuar në përvojë dhe mundësitë e punësimit për studentët tanë;
- 11.2. Zgjerimi i mundësive të zhvillimit profesional për të mbështetur shkëmbimin e njohurive, ndërtimin e partneriteteve dhe gjenerimin e të ardhurave;
- 11.3. Do të synojmë institucionet e arsimit të lartë me performancë të lartë dhe partnerët kërkimore që lidhen dhe mbështesin pikat e forta të zhvillimit dhe kërkimit tonë dhe mund të rrisin vlerën dhe ndikimin e kërkimeve tona;
- 11.4. Do të identifikojmë, hartojmë dhe ndjekim të diplomuarit tanë në mënyrën më efektive dhe do të sigurohemi që partneritetet tona me ta të synojnë të përputhin interesat e tyre me prioritetet tona.

**Rezultatet e pritshme**

- 11.1. Krijimi i një forumi të përhershëm me punëdhënësit;
- 11.2. Zhvillimi i një instrumenti feedback për punëdhënësit;
- 11.3. Shtimi i numrit të partnerëve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- 11.4. Rritja e numrit të marrëveshjeve të partneritetit për zhvillim dhe kërkim;
- 11.5. Rritja e numrit të projekteve të përbashkëta të zhvillimit dhe kërkimit;
- 11.6. Hartimi i një dokumenti politikash mbi partneritetin me të diplomuarit;
- 11.7. Krijimi i bazës së të dhënave për të diplomuarit;
- 11.8. Krijimi i rrjetit të të diplomuarve – ALUMNI FGJH;
- 11.9. Organizimi i një fushate për të tërhequr të diplomuarit tanë.



## Objektivi 12: Ndërkombëtarizimi i kurrikulës dhe i procesit të mësimdhënies dhe të nxënit dhe ofrimi i programeve dhe diplomave të përbashkëta

### Veprimet që do të kryhen:

- 12.1. Përfshirja e koncepteve kryesore të qytetarisë globale në përvojën e të nxënit të studentëve tanë dhe parimet e drejtësisë shoqërore, ekologjisë qytetare, zhvillimit të qëndrueshëm, garës së drejtë, kohezionit me komunitetin dhe shkëmbimit global; duhet të përshkojnë politikat dhe praktikatat tona arsimore në të gjitha nivelet;
- 12.2. Integrimi i kompetencave globale dhe ndërkulturore në kurrikula;
- 12.3. Zhvillimi i burimeve të mësimit elektronik për të mbështetur ndërkombëtarizimin dhe për të promovuar ndërgjegjësimin për çështjet globale të arsimit;
- 12.4. Ofrimi i programeve të përbashkëta me universitetet e huaja;
- 12.5. Promovimi dhe mbështetja e mundësive ndërkombëtare për studentët, duke përfshirë mundësitë afatshkurtra për studentët tanë për të studiuar në universitetet partnere, për internshipe ndërkombëtare dhe shkollat verore;
- 12.6. Promovimi i mundësive për shkëmbimin e studentëve të ofruara nga Programet e Bashkimit Evropian, si Erasmus+, Programet e Përbashkëta Master, Partneritetet Erasmus Mundus, programet dypalëshe të vendeve ose programe të tjera ndërkombëtare;
- 12.7. Ofrimi i mundësive për stafin akademik për të marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare;
- 12.8. Organizimi i të paktën një konference ndërkombëtare në vit;
- 12.9. Organizimi i Tavolinave të Rrumbullakëta për çështje që kanë lidhje me mësimdhënien dhe nxënien, integrimin e teknologjive të reja në mësimdhënie, me aktorë vendas dhe të huaj;
- 12.10. Zgjerimi i lidhjeve me partnerët strategjikë të kërkimit nëpërmjet rrjeteve universitare;
- 12.11. Tërheqja e studentëve ndërkombëtarë dhe mbështetja e tyre që ata të bëhen pjesë e komunitetit tonë.





### Rezultatet e pritshme:

- 12.1. Reflektimi i dimensionit ndërkombëtar dhe evropian në të gjitha programet e studimit;
- 12.2. Zhvillimi i një sërë kompetencash globale dhe ndërkulturore;
- 12.3. Pasurimi i koleksionit të bibliotekave të FGJH-së dhe mundësia e ofrimit të përdorimit të Bibliotekave virtuale (online) ofruar nga UT-ja apo partnerë të tjerë;
- 12.4. Ofrimi i programeve të përbashkëta me universitetet e huaja;
- 12.5. Organizimi i shkollave verore;
- 12.6. Rritja e numrit të internshipeve ndërkombëtare;
- 12.7. Rritja e numrit të shkëmbimit të studentëve;
- 12.8. Rritja e numrit të shkëmbimit të stafit akademik dhe administrativ;
- 12.9. Ngritja e një bazë të dhënash mbi shkëmbimet ndërkombëtare;
- 12.10. Ristrukturimi i zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe funksioni këshillues ndërkombëtar;
- 12.11. Përpilimi i një liste të revistave me faktor impakti dhe i konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 12.12. Ngritja e një baze të dhënash për projektet kërkimore dhe partnerët kërkimore;
- 12.13. Organizimi i konferencës ndërkombëtare çdo vit;
- 12.14. Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare;
- 12.15. Rritja e anëtarësisë institucionale dhe individuale në shoqata profesionale ndërkombëtare;
- 12.16. Rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë që ndjekin programet e ofruara në FGJH;
- 12.17. Përdorimi i platformës mësimore online për veprimtri mësimore/kulturore me të huaj;
- 12.18. Krijimi i një fryme dhe bashkësie ndërkombëtare studentore.




### Objektivi 13. Infrastruktura e shërbimeve

Sigurimi i një infrastrukture funksionale për mbarëvajtjen e procesit mësimor-kërkimor në Fakultet do të jetë qëllimi kryesor i stafit drejtues dhe administrativ. Duke besuar se në një shkallë të konsiderueshme infrastruktura është një element përcaktues për realizimin e ndryshimeve dhe zhvillimeve të pritura, janë parashikuar masa që do t'i japin mbështetje infrastrukturës fizike, hapësinore, laboratorike, informatike, teknologjike, informuese, dhe komunikuese.

#### Veprimet që do të kryhen:

- 13.1. Pajisja e klasave me infrastrukturën përkatëse dhe përmirësimi i ambienteve të higjenës personale;
- 13.2. Pasurimi i bibliotekës së Fakultetit nëpërmjet shtimit të fondit të librave në bibliotekë; Pajisja e bibliotekave me mjete bashkëkohore teknike (tabela interaktive, kompjutera, fotokopje, printera, etj);
- 13.3. Përmirësimi i faqes së internetit të Fakultetit dhe përditësimi i informacionit për pedagogët, studentët dhe publikun e gjerë;
- 13.4. Përmirësimi i lidhjeve të internetit dhe shtimi i pikave wireless në ambientet e Fakultetit;
- 13.5. Bashkëpunimi me Rektoratin e UT-së për funksionimin e sistemit elektronik të regjistrimit të studentëve (E-Studenti);
- 13.6. Organizimi i infrastrukturës për të mbështetur kategorinë e studentëve me nevoja të veçanta;
- 13.7. Implementimi i Labororit Përkthim-Interpretimi për rritjen e cilësisë së mësimdhënies;
- 13.8. Pajisja e secilit Departament me kompjutera;
- 13.9. Krijimi i një laboratorit për didaktikën e gjuhës së huaj dhe vendosja e tabelave interaktive në auditore;



- 13.10. Ofrimi i asistencës për këshillime psiko-sociale nëpërmjet psikologëve në Fakultet;
- 13.11. Ofrimi i shërbimit të fotokopjes për studentët brenda institucionit me tarifa më të lira se jashtë Fakultetit në mënyrë që të ardhurat e përfituara të vihen në shërbim të përmirësimit të infrastukturës për studentët;
- 13.12. Organizim i përvitshëm i ceremonisë së diplomimit të studentëve.

**Objektivi 14. Ndërveprimi i Fakultetit me komunitetin dhe institucionet lokale**

- 14.1. Krijimi i nismave dhe veprimeve konkrete për një Fakultet dhe një komunitet sa më ekologjik duke ndërvepruar me institucionet lokale;
- 14.2. Organizimi i shkollave verore për edukimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të barazisë gjinore dhe angazhimit qytetar;
- 14.3. Organizimi i trajnimeve për kulturën e demokracisë, vullnetarizmit, etj.

**Miratoi**

**Dekani**

**Prof. Dr. Esmeralda Kromidha**

